



stay & thrive

**Nxitja e qëndrimit të të rinjve në vend
përmes biznesit dhe kulturës**

Ky raport është përgatitur nga Dr. Aidan Hehir dhe Jeta Zagragja dhe është financuar nga Open Society Foundations – Ballkani Perëndimor. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Open Society Foundations – Ballkani Perëndimor.

Hyrje

Migrimi i të rinjve jashtë vendit është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet Kosova. Edhe pse investimet e jashtme janë të nevojshme për ta përmirësuar këtë, brenda Kosovës ekziston potencial i pashfrytëzuar për të zhvilluar industri vendore të qëndrueshme. Inkurajimi dhe mbështetja e sipërmarrësve lokalë është thelbësore për krijimin e vendeve të punës dhe prosperitetit.

Rritja e mundësive kulturore luan gjithashtu një rol vendimtar në mbajtjen e të rinjve të Kosovës. Një skenë kulturore dinamike i inkurajon njerëzit të qëndrojnë dhe krijon vende pune; jashtë vendit, ajo rrit turizmin dhe përforcon “fuqinë e butë” të vendit në arenën ndërkombëtare.

Fuqizimi i rritjes dhe parandalimi i migrimit të të rinjve kërkon një qasje të dyfishtë: qeveria duhet të përqendrohet në mbështetjen e sipërmarrësve ekonomikë dhe kulturorë për të ruajtur talentin e të rinjve dhe për të zhvilluar ekonominë e Kosovës. Projekti ynë u hartua për të identifikuar strategji inovative që të mundësojnë arritjen e të dy këtyre qëllimeve.

Kostoja e migrimit

Migrimi neto i Kosovës ka qenë negativ gjatë dhjetë viteve të fundit, dhe në vitin 2024 Kosova u rendit e dyta ndër “Gjashtë Vendet e Ballkanit Perëndimor” (BP6) si për numrin e migrantëve (22,178) ashtu edhe për migrantët si përqindje e popullsisë (1.3%). Sipas vlerësimeve, **rreth 800,000 kosovarë jetojnë jashtë vendit**; duke përfshirë gjeneratën e dytë të migrantëve, shifra arrin afërsisht **950,000**, duke bërë Kosovën **një nga pesë vendet kryesore me normën më të lartë të emigrimit në botë**.

Migrimi jashtë vendit mund të ndihmojë në lehtësimin e presionit në tregun e punës, ndërsa ata që janë shpërngulur jashtë fitojnë aftësi të reja, përvojë të vlefshme profesionale dhe krijojnë rrjete të reja biznesi. Megjithatë, “ikja e trurit” shkakton gjithashtu kosto ekonomike të konsiderueshme; çdo individ me potencial punësimi që emigron nga Kosova humbet mesatarisht rreth **17,000 €** në vit nga potenciali i ardhshëm i BPV-së. **Emigrimi ka krijuar gjithashtu çrregullime në tregun e punës dhe mungesa të personelit të kualifikuar**, veçanërisht në sektorë si shëndetësia, arsimi, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, ndërtimi, tregtia me pakicë, turizmi, bujqësia dhe zhvillimi rural.

Pse largohen njerëzit?

Pagat e ulëta dhe mundësitë e kufizuara të punës përbëjnë arsyet kryesore të trendit të migrimit nga Kosova. Paga mesatare bruto në Kroaci është më shumë se dyfish më e lartë se në Kosovë, ndërsa në Gjermani dhe Austri është shtatë herë më e lartë. Për më tepër, shumë vende të Bashkimit Evropian po përballen me plakjen e shpejtë të popullsisë, gjë që ka shkaktuar një kërkesë të shtuar për fuqi punëtore të huaj; si Austria ashtu edhe Gjermania kanë miratuar legjislacion të ri që ofron mundësi për migrim për punë nga Kosova.

Ekonomia e Kosovës

Pavarësisht një konteksti ndërkombëtar jashtëzakonisht sfidues, ekonomia e Kosovës po performon mirë dhe shquhet për një gamë të gjerë iniciativash sipërmarrëse të suksesshme dhe tërheqëse, si në fushën e biznesit, ashtu edhe në kulturë. Kosova ka tejkaluar vendet e tjera të BP6 **në rritjen e BPV-së, bilancin fiskal, të ardhurat tatimore dhe inflacionin**.

Megjithatë, sfidat kryesore mbeten të pranishme. Shkalla e lartë e varfërisë dhe varësia e madhe nga remitencat vazhdojnë të jenë shqetësuese. **Tregu i punës në Kosovë përballet ende me pjesëmarrje shumë të ulët, papunësi të lartë (sidomos tek të rinjtë) dhe hendeqe të mëdha gjinore.** Nga perspektiva ndërkombëtare, Banka Botërore dhe FMN kanë paralajmëruar se Kosova përballet me sfida të jashtme të nxitura nga ngadalësimi i mundshëm i ekonomive kryesore evropiane, barrierat më të larta tregtare dhe ndërprerjet e shaktuara nga konfliktet gjeopolitike. Këto do të ndikojnë në rrjedhat e financimeve të jashtme, tregjet e mallrave, turizmin, zinxhirët e furnizimit dhe Investimet e Huaja Direkte, dhe ka të ngjarë të çojnë në kushte më të rrepta financiare dhe inflacion më të lartë. Në rast se ekonomia e Kosovës do të dobësohet, kjo padyshim do të rezultojë në një rritje të migrimit.

Gjetjet

Anketimi² i studentëve të vitit të fundit tregoi një lidhje të fuqishme emocionale me Kosovën; 50% pajtohen/pajtohen fuqimisht se

¹ Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia.

² Në shkurt 2025, UBO Consulting u angazhua për të realizuar një anketë me 250 studentë të vitit të fundit nga Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Prizrenit, International Business College Mitrovica dhe Rochester Institute of Technology. Intervistat me sipërmarrës në biznes dhe kulturë u zhvilluan mes marsit dhe majit 2025, ndërsa në maj u mbajtën dy punëtori me sipërmarrës të të dy fushave në Prishtinë në maj 2025.

Kosova ofron një balancë të mirë punë/jetë; 55% pajtohen/pajtohen fuqimisht se ekziston një 'ndjenjë e fortë komuniteti dhe përkatësie' në Kosovë; 56% kishin 'një lidhje emocionale të fortë me Kosovën' dhe **60% thanë se ndiheshin 'të përgjegjshëm për të kontribuar në zhvillimin e Kosovës'.**

Anketa tregoi gjithashtu se 54% pajtohen/pajtohen fuqimisht që më shumë mundësi për ndërmarrësi në biznes, dhe 43% se më shumë mundësi për ndërmarrësi kulturore do t'i inkurajonin ata të qëndronin. 52% e studentëve thanë se 'më shumë ngjarje kulturore' dhe 50% se 'më shumë mundësi për ndërmarrësi biznesi' do t'i inkurajonin të qëndronin. 49% besojnë se Kosova 'duhet të bëjë më shumë për të promovuar sipërmarrësit e saj të suksesshëm', ndërsa vetëm 35% besojnë se ka mjaftueshëm mundësi për sipërmarrës në Kosovë, vetëm pak më e lartë se 32% që nuk pajtohen. **Këto rezultate tregojnë se investimi dhe mbështetja në sipërmarrësit afaristë dhe kulturorë në Kosovë do t'i inkurajojë të rinjtë të qëndrojnë.**

Gjatë intervistave dhe punëtorive me sipërmarrës në biznes dhe kulturë, u evidentua se Kosova ka një kulturë sipërmarrëse unike dhe inovative, e karakterizuar nga **qëndrueshmëria, iniciativa dhe pavarësia**. Megjithatë, u arrit një konsensus i gjerë se qeveria nuk ka ofruar mbështetjen e mjaftueshme për sipërmarrësit; si rrjedhojë, shumë prej tyre ndihen të pasigurt dhe konsiderojnë largimin nga vendi. Për më tepër, vendimmarrësit në qeveri – si në nivelin komunal ashtu edhe në atë qendror – shpesh nuk janë të ndjeshëm ndaj nevojave të sipërmarrësve dhe krijojnë pengesa burokratike të panevojshme që pengojnë zhvillimin e ndërmarrësisë.

Përpyqjet e qeverisë për të promovuar arritjet dhe mundësitë ekonomike dhe kulturore të Kosovës u kritikuan gjerësisht; ekzistonte një konsensus i gjerë se është e domosdoshme të rritet njohja dhe mbështetja politike në nivel lokal për të inkurajuar angazhimin në mundësi afariste dhe kulturore, si dhe për të përforcuar promovimin ndërkombëtar për të tërhequr turistë dhe investime të huaja.

Rekomandimet

Zëvendësmentaxherja e Bankës Botërore për Kosovën theksoi se vendi duhet të **'kalojë në një model të rritjes ekonomike konkurruese që siguron më shumë vende pune dhe të cilësisë më të lartë për të gjithë qytetarët e Kosovës'**. FMN dhe OBZHE rekomanduan po ashtu që Kosova të investojë në kapitalin njerëzor dhe të përmirësojë klimën e biznesit për të nxitur ndërmarrësinë dhe për të tërhequr investime të jashtme që krijojnë vende pune.

Në këtë mënyrë, nxitja e ndërmarrësisë njihet qartë si një faktor kyç për të mbrojtur Kosovën nga rënia ekonomike në të ardhmen dhe nga migrimi i shtuar jashtë vendit. Hulumtimet tona tregojnë se mbështetja dhe inkurajimi i sipërmarrësve në Kosovë kërkon veprime të konsiderueshme shtesë.

Për arritjen e këtij qëllimi, ne propozojmë rekomandimet e mëposhtme:

Arsimi

- **Kurrikula kombëtare** duhet të **rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të përshtatet** me kërkesat e tregut bashkëkohor të punës, duke garantuar që të rinjtë të pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për konkurrencë në një ekonomi moderne.
- **Shkollat dhe universitetet** duhet të integrojnë më shumë përmbajtje praktike në programe, në mënyrë që të rinjtë të **mësojnë aftësi specifike përmes arsimit dhe praktikave profesionale duke u përgatitur kështu më mirë për punësim** dhe për nisma sipërmarrëse.
- **Duhet adresuar boshllëqet që lidhen me aftësitë specifike të industrisë.**

Qasjet shoqërore

- Qeveria duhet të promovojë kulturën e ndërmarrësisë në të gjitha nivelet e shoqërisë, **të sfidojë qëndrimet hezitues** – sidomos brenda sektorit bankar – ndaj **inovacionit dhe marrjes së rrezikut**, si dhe të nxisë zhvillimin e një kulture dinamike investimi.
- Qytetarët e Kosovës duhet të ndjekin një qasje të ndryshme ndaj punësimit dhe ndërmarrësisë, që inkurajon ambicien dhe inovacionin.

- Qeveria duhet të punojë për të ndryshuar perceptimin e përhapur se puna jashtë vendit ofron pagë dhe karrierë më të mirë, duke vënë në dukje aspektet negative të emigrimit – sidomos koston më e lartë e jetesës jashtë vendit – dhe duke promovuar mundësitë në rritje për zhvillim profesional brenda Kosovës.

Mbështetja e qeverisë

- Qeveria **duhet të zhvendosë vëmendjen nga përplasjet politike dhe të përqendrohet në mbështetjen aktive të sipërmarrësve** në funksion të zhvillimit të Kosovës, duke inkurajuar edhe mediat vendore që ta bëjnë të njëjtën gjë.
- Është e domosdoshme që qeveria të **realizojë një studim për të identifikuar praktikat më të mira të zbatuara në vendet tjera** dhe të punojë për zbatimin e masave të ngjashme në kontekstin kosovar.
- Duhet të sigurohet **mbështetje më e madhe financiare për sipërmarrësit kulturorë dhe afaristë – përmes përjashtimeve tatimore, skemave të financimit dhe kredive me interes të ulët** – duke u dhënë njëkohësisht më shumë dukshmëri skemave ekzistuese.
- Qeveria duhet **të ndërmarrë reforma të thella financiare** – në bashkëpunim me përfaqësuesit e sektorit privat – që synojnë përmirësimin e klimës së biznesit, me fokus në zvogëlimin e barrës tatimore, normave të larta të interesit për kreditë investuese, mbledhjen e TVSH-së në momentin e importit para shitjes së produkteve, thjeshtimin e legjislacionit të punës dhe zhvillimin e infrastrukturës energjetike.
- **Skemat e financimit qeveritar për sipërmarrësit kulturorë dhe afaristë** duhet të reformohen për t'u bërë më pak burokratike, më efikase dhe me përfshirje më të madhe të vetë sipërmarrësve, në mënyrë që politikat të reflektojnë realisht nevojat e tyre profesionale.
- Qeveria duhet **të rrisë fondet e dedikuara për programe trajnimi dhe mentorimi**, të krijojë parqe të dedikuara për inovacion dhe të ndërtojë një ekosistem të qëndrueshëm që e mbështet zhvillimin e sipërmarrësve në Kosovë.
- Në fushën e kulturës, duhet të sigurohen **më shumë hapësira publike – si salla, ndërtesa etj.** – për organizimin e ekspozitave, punëtorive, provave dhe performancave artistike; të ndahet një fond i posaçëm për këto hapësira dhe të krijohet një program rezidence për artistët.
- Gjithashtu, qeveria duhet të intensifikojë përpjekjet **për të tërhequr investimet e huaja direkte në Kosovë**, të thjeshtojë procedurat për krijimin e bizneseve në Kosovë dhe të lehtësojë investimet e diasporës së Kosovës në nismat sipërmarrëse brenda vendit.

Promovimi

- **Arritjet dhe mundësitë sipërmarrëse kulturore dhe afariste të Kosovës duhet të promovohen në shkolla** për të frymëzuar të rinjtë që të qëndrojnë në Kosovë.
- Qeveria duhet të investojë **dukshëm më shumë kohë dhe mjete financiare për të promovuar në mënyrë ndërkombëtare** arritjet dhe mundësitë sipërmarrëse kulturore dhe afariste të Kosovës, me qëllim të rritjes së investimeve të huaja dhe forcimit të reputacionit ndërkombëtar të Kosovës.
- Qeveria duhet të intensifikojë përpjekjet për **krijimin e programeve të rezidencave të shkëmbimit për sipërmarrësit kulturorë dhe afaristë**, me qëllim të thellimit të angazhimit ndërkombëtar të Kosovës dhe të mundësitimit që sipërmarrësit kosovarë të përfitojnë aftësi dhe përvoja të çmuara jashtë vendit.

If Kosovo is to maintain healthy economic growth and reduce youth migration, it must support entrepreneurship; we believe the implementation of these recommendations will achieve this goal.



Dr Aidan Hehir

Profesor i Marrëdhënieve
Ndërkombëtare, Universiteti i
Westminster



Jeta Zagragja

Kryeshefe Ekzekutive dhe
Themeluese, AnchorzUp